



Ensuring rights and choices for all since 1969

EDUKATA SEKSUALE GJITHËPËRFSHIRËSE



ICPD25

International Conference on
Population and Development

Punuar nga:

Gerti Janaqi

Edlira Sina

Gentiana Qirjako

Në shkolla

1. Hyrje

Prindërit dhe familja luajnë një rol kyç në formimin e mënyrës se si ne i kuptojmë identitetet tona seksuale dhe shoqërore. Prindërit duhet të jenë të aftë t'u adresojnë fëmijëve aspektet fizike dhe të sjelljes të seksualitetit njerëzor si dhe fëmijët duhet të jenë të informuar dhe të pajisur me njohuritë dhe aftësitë për të marrë vendime të përgjegjshme rreth seksualitetit, marrëdhënieve, HIV-it dhe sëmundjeve të tjera seksualisht të transmetueshme. Sot, shumë të rinj nuk marrin përgatitjen e duhur për jetën e tyre seksuale. Kjo i bën ata më të prirur ndaj sforcimeve në zgjedhjen e partnerit, apo pre e dhunimit dhe shfrytëzimit, shtatëzanive të padëshiruara dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (SST), përfshirë dhe HIV-in. Përgatitja e fëmijëve dhe të rinjve për kalimin në moshën madhore ka qenë gjithmonë një nga sfidat më të mëdha të njerëzimit, me në qendër seksualitetin dhe marrëdhëniet njerëzore. Nëse dëshirojmë të kemi një ndikim tek fëmijët dhe të rinjtë përpara se këta të jenë seksualisht aktivë, është e domosdoshme ***përfshirja e edukimit seksual gjithëpërfshirës*** nëpërmjet zbatimit të programeve mësimore. Mësuesit janë një burim i paçmueshëm në luftën kundër SST, në sektorin arsimor. Duhet bërë gjithashtu përpjekje të veçanta për të arritur ata fëmijë, të cilët nuk shkojnë në shkollë dhe që janë shpesh më të prirur ndaj keqinformimit dhe shfrytëzimit. Në këtë kontekst, **në kuadër të reformës që ka përfshirë arsimin parauniversitar në Shqipëri, UNFPA, MASR dhe INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT (sot AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR)** kanë konceptuar një ndërhyrje multidimensionale në sistemin arsimor me qëllim pajisjen e mësuesit me qëndrimet, njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të planifikuar dhe për të lehtësuar mësimdhënien e edukimit seksual në shkollë.

2. Konteksti historik mbi tentativat e hershme për ta institucionalizuar edukatën seksuale në sistemin arsimor në Shqipëri

Edukimi shëndetësor-seksual si dimension shkollimi u bë pjesë e sistemit arsimor shqiptar në vitet 1995 deri në vitin 2005. Në kushtet kur sistemi ynë arsimor po hapej ndaj sistemeve të tjera të shkollimit, kur shoqëria po ballafaqohej me kultura të tjera, kur komunikimi verbal, joverbal dhe ai teknologjik po bëheshin gjuhë të kohës, të rinjtë po ballafaqoheshin me sjellje të reja që vinin në pikëpyetje kuptimet dhe qëndrimet e tyre ndaj shëndetit riprodhues dhe sjelljeve seksuale. Ekspertët e ISP, IZHA./ASCAP identifikuan si nevojë, edukimin

shëndetësor/seksual dhe arritën të bindin politikbërësit që të bëhej pjesë e kurrikulës zyrtare shkollore.

Ky dimension shkollimi u shtri në klasat e treta të ciklit të ulet si pjesë e lëndës “Dituri Natyre” dhe në klasat 5-8, si lëndë më vete. Kjo hapësirë kohore shënon dhe pikën më të lartë të vendimmarrjes politike në sistemin e edukimit. Identifikimi i nevojës për edukim shëndetësor-seksual në shkollë, u shoqërua me paketa materialesh për nxënës, mësues dhe prindër. Kjo periudhë shënon dhe *institucionalizimin* e edukimit shëndetësor/seksual si pjesë e shkollimit në Shqipëri. *Në vitet që pasuan edukimit shëndetësor/seksual iu bashkëngjiti dhe dimension i aftësisë për jetën, ku mori zhvillim dhe sjellja seksuale, seksualiteti, pasojat e sjelljes seksuale jo të shëndetshme, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, repertori sjellor me bazë formim seksual, etj. Kështu, koncepti për edukimin shëndetësor fitonte nga vit në vit përmasa të reja.*

I gjithë procesi i instalimit të edukimit shëndetësor/seksual, ka qenë dilematik dhe paradoksal:

- **Paradoksal**, sepse ky dimension edukimi merrte jetë në kushtet kur vetë stafi mësimor kishte të mbartura problematika që lidheshin me formimin e tyre të munguar, problematik dhe barriera socio-kulturore në aspektin e edukimit seksual.
- **Dilematik**, pasi, institucionet që kishin identifikuar nevojën për të bërë pjesë të sistemit edukimin shëndetësor/seksual, ballafaqoheshin me kundër-argumente dhe barriera që vinin nga faktorë të tjerë të interesuar për shkollën. Shkolla dhe faktorë të caktuar relativisht nuk ishin të gatshëm të përmbushin cilësisht edukimin shëndetësor/seksual. Tabutë e kanë shoqëruar këtë proces.

Aktualisht, ekspertët kanë risjellë në fokus nevojën për të riformtuar edukimin shëndetësor me fokus “Edukimin seksual si aftësi për jetën” në sistemin e shkollimit. Kjo bëhet emergjente në kushtet kur të rinjtë ballafaqohen me mosnjohjen **sa** dhe **si** duhet të menaxhimit të shëndetit të tyre riprodhues.

3. Dimensionet e edukimit seksual gjithëpërfshirës në sistemin arsimor parauniversitar shqiptar

Edukimi shëndetësor me fokus “Edukimin seksual si aftësi për jetën” përfaqëson një nga qëllimet bazale të edukimit dhe konsiderohet dimension substancial i formimit të individit. Ky formim kërkon një investim të qëllimtë, në kohën¹, cilësinë,² dhe metodologjitë³ e kërkuara në stade të ndryshme të jetës së çdo individit. Shpesh mësuesit kanë nevojë specifike të hulumtojnë peshën dhe rëndësinë e këtij formimi, të ballafaqohen jo vetëm me nevojën për të përcjellë këtë dimension tek të rinjtë, por dhe të identifikojmë vështirësitë potenciale që mbart ky dimension edukimi në mënyrën se si shkollat e përmbushin.

Edukimi shëndetësor me fokus- “Edukimi seksual si aftësi për jetën” ***ka si qëllim shkollimi përmbushjen e nocionit të “kuptimit të vetes”.*** Ky nocion është pjesë e sistemit të edukimit. Edhe pse i besohet shkollës, edhe pse bëhet pjesë e kurrikulës shkollore, shoqërohet dhe përmbushet përmes dilemave dhe situatave paradoksale. Në substancë, edukimi seksual shënjon fillimin e dimensionit të edukimit ***“kuptimi për veten”*** dhe i jep relativisht përgjigje pyetjeve që lidhen me identitetin sidomos në moshën e pubertetit...

Edukimi shëndetësor me fokus- “Edukimi seksual si aftësi për jetën” ***përmbushet në një kontekst të caktuar kulturor.*** Në varësi të kontekstit socio-kulturor çdo individ reflekton një repertor sjellor të caktuar që dëshmon cilësinë/mos-cilësinë/deformimin/mirë-formimin e këtij dimensionit edukimi. Edhe në rastin tonë ky dimension edukimi përmbushet dhe fiton të njëjtat simptoma që ka shoqëria. Ky proces fiton të njëjtat tipare që komuniteti ynë ka rreth edukimit seksual. Nuk janë imun as ekspertët e edukimit, të kurrikulës, të teksteve, mësuesit, trajnuesit, që përmbushin detyrimin e tyre për të hartuar politikat për edukimin seksual brenda formimit/mos formimit/ që ata kanë. Kësisoj, të rinjtë do të marrin ***substancën*** e asaj që ekspertët kanë rreth këtij dimensionit edukimi. Ndaj pyetja lipset të shtrohet: Në çfarë mase, ekspertët e edukimit janë të gatshëm profesionalisht, etiketisht, metodologjikisht të përmbushin qëllimet e këtij dimensionit edukimi...?

Edukimi shëndetësor me fokus “edukimi seksual si aftësi për jetën” ***zbatohet në një kontekst ligjor në edukim.*** Ligji i Arsimit Parauniversitar, potencon zhvillimin tërësor të edukimit shëndetësor dhe seksual të rinjve dhe e identifikon si detyrë të sistemit për ta përmbushur këtë dimension shkollimi. Shprehimisht ligji nënvizon se:⁴*Sistemi arsimor parauniversitar ka*

¹ Cikli i shkollimit kur fillon edukimi seksual

² Kurrikula shkollore, hapësira që i le edukimit seksual

³ Formimi profesional i mësuesit që përmbush edukimin

⁴ LIGJI Nr. 69/201

për qëllim formimin e çdo individi, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes, të jetë i përgjegjshëm për familjen, shoqërinë e kombin etj...

4. Pse programi i Edukimit shëndetësor me fokus “edukimi seksual si aftësi për jetën” institucionalizohet në shkollë

Shkolla është “habitati natyror” ku mund të përmbushet dija rreth edukimit seksual.

Shkollat ofrojnë kontekstin socio-psikologjik ku të rinjtë tentojnë të ndërtojnë stilet e jetesës. Fëmijët e moshës shkollore, zhvillojnë repertorin sjellor nëpërmjet ndërveprimit me bashkëmohatarët dhe e ballafaqojnë këtë repertor me edukatorët dhe mësuesit. Shkollat janë gjithashtu mjedise ideale për të përmbushur dhe promovuar edukimin seksual nënkuptuar edukimin shëndetësor edhe për disa arsye të tjera:

- Shkollat zbatojnë proceset e edukimit referuar kurrikulës zyrtare, por edhe kurrikulës në bazë shkolle. Ato e përmbushin qëllimin e shkollimit në një hapësirë kohore të mirë-strukturuar të organizuar në cikle shkolli referuar parametrave moshor dhe psiko-sociale;
- Shkollat si institucione kanë detyrim ligjor të udhëheqin të rinjtë drejt maturimit social dhe pjekurisë seksuale si sjellje individuale sociale..;
- Shkolla si institucion punon me *personel të trajnuar* për të udhëhequr dimensionin e edukimit seksual;
- Shkolla si institucion social udhëheq proceset e edukimit seksual referuar nevojave fiziologjike të grup-moshës, duke theksuar pikat kritike ku ndodh zhvillimi fiziologjik i tyre;
- Shkollat si institucione sociale njëkohësisht janë shumëfishues të politikave efektive që *shpërndajnë efektin në* familje për edukimin shëndetësor.
- Shkollat si institucione sociale **mund të jenë ura komunikimi me komunitetin** nëpërmjet projekteve të ndryshme ose nëpërmjet komuniteteve ndërsektorale lokale;

5. ACTIONS, POLICY REFORMS, AND DEVELOPMENT OF A NATIONAL PROGRAMME

Në fillim të vitit 2015, UNFPA, MASR dhe IZHA (sot AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR) filluan programin për të rikthyer institucionalizimin e edukatës shëndetësore dhe seksuale në arsimin parauniversitar shqiptar. Koncepti i institucionalizimit shtrihet në 2 nivele: 1) në shkrimin e kurrikulës së edukimit shëndetësor, 2) trajnimin e mësuesve

Ky program ka disa karakteristika:

- Programi është zbatuar në nivel kombëtar.
- Programi nuk është i transferuar nga përvoja të huaja. Është identifikuar si nevojë nga ekspertiza shqiptare, po përmbushet nga mësues shqiptarë dhe monitorohet nga ekspertë të MASR, ASCAP.
- UNFPA ka ofruar mbështetjen financiare të programit dhe është përkujdesur që programi të zhvillohet në kohën e duhur në respekt të hapësirave akademike që lejon plani mësimor.
- Programi ka prekur tri nivele shkollimi: *fillor, i mesëm i ulët, i mesëm i lartë.*
- Programi ka ngritur kapacitete *lokale trajnuese të mësuesve të arsimit fillor, të biologjisë, qytetarisë, edukimit fizik, sport dhe shëndet.*
- Programi ka certifikuar mësues TOT në çështjet e edukimit shëndetësor me fokus edukimin seksual.
- Është pjesë e Urdhrit Ministerial për fillim vitin akademik 2016-2017-2018-2109-2020
- Programi ka ofruar tek mësuesit botime sipas cikleve shkollore, që janë paketa kurrikulare, didaktike dhe informuese.
- Kontekstualizimi i programit referuar specifikave socio-kulturore të shkollës dhe komunitetit, ka evituar mundësitë potenciale që programi të aplikohet në forma shabllone. Çdo shkollë, mësues, ka pasur mjaftueshmërisht lirinë akademike për të identifikuar temat mësimore, metodologjitë specifike për të zhvilluar çështjet substanciale te edukimit shëndetësor dhe seksual.

- Programi për nga mënyra se si është përcjellë në shkolla dhe në trajnime ka “reduktuar” mjaftueshëm keqinformimin rreth këtyre çështjeve sensitive që deri pak kohë më parë janë konsideruar tabu.

Paketë Kurrikulare me fokus: “edukimi seksual si aftësi për jetën” adresuar mësuesve në tri ciklet e shkollimit: fillor, i mesëm i ulët, i mesëm i referohet specifikave që ka secila grup-moshë. Kjo paketë kurrikulare ka tri dimensione:

- **Shkencor** të mirëfilltë që lidhen me probleme fiziologjike dhe ndryshime hormonale, përtej njohurive që ofrojnë lëndët e Biologjisë dhe Edukimit Fizik. Njohje të trupit dhe të vetvetes si dhe ndryshimeve sjellore që shoqërojnë pubertetin dhe adoleshencën, përtej njohurive që ofrohen në lëndët e Qytetarisë dhe Edukatës qytetare.
- **Njohuri** rreth repertorit sjellor dhe vetëmenaxhimit që të rinjtë/mësuesit shfaqin në grup mosha të caktuara kur ballafaqohen me ndryshimet hormonale.
- **Edukimin për shëndetin seksual** si domosdoshmëri përtej kufijve të “tabusë”.

Konceptimi dhe zbatimi i kurrikulës bërthamë me fokus “edukimi seksual si aftësi për jetën” gjeneroi **tematikat kros-kurrikulare në të gjitha ciklet e arsimit nga klasa e 4 deri në gjimnaz, grupmosha 10 deri në 18 vjeç.**

Në arsimin fillor, edukimi seksual, nis me lëndën e diturisë së natyrës (në tematikat që i përkasin biologjisë). Përmes kësaj lënde nxënësit mësojnë rreth cikleve jetësore të njeriut dhe kafshët, përfshirë riprodhimin. Ata nisin të kuptojnë konceptet e riprodhimit dhe rritjes, por jo se si ndodh riprodhimi.

Edukimi seksual i trajtuar përmes kurrikulës zyrtare të biologjisë formëson edukimin seksual në aspekte që lidhen me zhvillimin e trupit në grup mosha të caktuara, organet riprodhuese, pjekurinë seksuale dhe nevojat fiziologjike të grup-moshës, duke nënvizuar pikat kritike, ku ndodh zhvillimi fiziologjik i tyre.

Edukimi seksual i trajtuar përmes kurrikulës zyrtare të edukimit fizik, sportit dhe shëndetit zhvillon fusha të përmbajtjes që lidhen me veçoritë njohëse, psikologjike e sociale të rinjtë. Tematika “Edukim në shërbim të komunitetit, mirëqenies dhe shëndetit”, u mundëson nxënësve fitimin e kompetencave për ruajtjen dhe kultivimin e shëndetit të tyre dhe të tjerëve. Nëpërmjet njohurive të kësaj tematike nxënësve u mundësohet njohja me konceptin e identitetit gjinor dhe vlerave identifikuese sipas përkatësisë gjinore.

Edukimi seksual përmes kurrikulës zyrtare të qytetarisë

Nëse do ti referoheshim një kuptimi më të gjerë të seksualitetit⁵ kurrikula e qytetarisë merr përsipër të trajtojë çështje nisur nga perspektiva e zhvillimit personal, social dhe repertorit sjellor. Në programin e qytetarisë, tematikat "**Individët, grupet, shoqëria**" dhe "**Shëndeti**" pikëpëriten me fusha të përmbajtjes së edukimit seksual. Njohuritë për secilën tematikë që paraqiten më poshtë cilësohen nga ekspertët si të domosdoshme për të fituar ndryshime për sjellje të shëndetshme.

6. A TIMELINE OF MAIN DEVELOPMENTS DURING THE LAST DECADE WHICH CULMINATED WITH THE START OF THE NATIONAL SCREENING PROGRAM

Timeline	Intervention, policy change, progress	Main Stakeholders and partners
1995/2005	Edukata seksuale u fut ne kurrikulën e APU ne klasën 3 te ciklit të ulet si pjesë e lëndës “Dituri Natyre” dhe në klasat 5-8, si lëndë më vete.	MOESY, IED, UNFPA
2015	Kurrikula e re bërthamë me fokus “edukimi seksual si aftësi për jetën”, formati kroskurikul nga klasa 4-12 në lëndët e biologjisë, edukim fizik dhe qytetari	MOESY, IED, UNFPA
2016	Hartohen udhëzuesit didaktik për mësues dhe nxënës mbi edukimin shëndetësor me fokus “edukimi seksual si aftësi për jetën” <i>për ciklet e arsimit fillor, arsimit mesëm i ulët- AMU dhe arsimit mesëm i lartë – AML/ gjimnaz</i>	MOESY, IED, UNFPA
2016	Ngrihet për here të parë rrjeti 150 mësuesve TOT të trajnuar mbi çështje të edukimit shëndetësor me fokus shëndetin seksual	MOESY, IED, UNFPA
2017	Hartimi i paketës didaktike dhe trajnuese për edukimin shëndetësor me fokus “edukimi seksual si aftësi për jetën” <i>për ciklet e arsimit fillor, arsimit mesëm i ulët- AMU dhe arsimit</i>	MOESY, IED, UNFPA

⁵Nënjë kuptimi më të gjerë të seksualitetit (sipas OBSH) shkencat sociale mbulojnë aspekte shoqërore, morale dhe të marrëdhënieve.

mesëm i lartë – AML/ gjimnaz			
2017	Hartohen standardet e profilit të mësuesit për edukimin shëndetësor me fokus <i>“Edukim seksual dhe aftësi për jetën”</i>	MOESY, UNFPA	IED,
2018	Avokati për statusin e programit <i>“Edukim seksual dhe aftësi për jetën” në bashkëpunim me universitetet ku formohen mësues ne lidhje me statusin i edukimit seksual në kurrikulën që përgatit mësues të rinj;</i> Avokati nga mësuesit për mësuesit , referuar përvojave të krijuara përgjatë zbatimit të programit deri aktualisht;	MOESY, UNFPA	IED,
2018	Përgatitja e materialeve didaktike për mësues dhe nxënës: <ul style="list-style-type: none"> • Programe të detajuara për çdo vit shkollimi te mbështetura në kurrikulën bërthamë (grupmosha 10-18 vjeç); • Planifikime vjetore, planifikime periodike sipas tremujorëve për çdo cikël shkollimi dhe për profilet biologji, qytetari, edukim fizik sport dhe shëndet. • Orë mësimore të dedikuara /plan-ditarë sipas temave të planifikuara vjetore akademike; • Përgatitja e materialeve didaktike “Nga mësuesit për mësuesit”. • Evidentimi i përvojave pozitive në orë mësimore të lëndëve të ndryshme dhe mundësimi i reflektimit të tyre ne shkallë vendi. 	MOESY, UNFPA	IED,
2019	Shkruhen udhëzues specifik me fokus Abuzimi seksual. Udhëzues për mësues, prindër, nxënës.	MOESY, UNFPA, Faculty of Social Science	IED,
2017-2019	Monitorime për zbatueshmërinë e programit Shpërndarja dhe zbatimi i “Paketës kurrikulare” në shkollë dhe monitorimi i saj në shkallë kombëtare, forcimi i kapaciteteve lokale trajnuese në çdo DAR /ZA; vlerësimi i zbatimit të materialeve burimore didaktike në shkollë në çdo cikël shkollimi të arsimit parauniversitar.	MOESY, UNFPA,	IED,
2015-2020	Përfshirja ne udhëzimin e fillim-vitit akademik te MAS, MASR, 2016-2017; 2017-2018, 2018-2019, 2019-2020 për	MOESY, UNFPA,	IED,

7. TRAJNIMI I MËSUESVE

Trajnimi i mësuesve për edukimin seksual është një element që shpesh neglizhohet. Në këtë aspekt, përmirësimet janë vërtet të nevojshme. Mungesa e përgatitjes së mësuesve për t'i mësuar dhe për t'i motivuar nxënësit që të mësojnë siç duhet, mund të cenojë rezultatet. Trajnimi i mësuesve është gjithashtu i rëndësishëm sepse këto janë tema të ndjeshme dhe mësuesit mund ta kenë të vështirë t'i trajtojnë. Fokusi i edukimit të mirë seksual është jo vetëm tek transferimi i njohurive, por edhe tek diskutimi i normave (të dëmshme) sociale dhe gjinore, si dhe tek zhvillimi i të menduarit kritik. Për këtë, nevojiten metoda mësimore me pjesëmarrje dhe me ndërveprim, në mënyrë që të jenë efektive.

IZHA (sot AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR) ka zbatuar dhe monitoruar një program gjithëpërfshirës trajnimi të edukimit seksual për mësuesit prej vitit 2015. IZHA hartoi paketën **didaktike trajnuese për mësues me fokus “Edukimi seksual si aftësi për jetën”** për ciklet e arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë. Gjithashtu ky program certifikimi për mësues TOT u akreditua nga MASR për të shpërblyer mësuesit me kredite falas.

Deri në fund të vitit 2016 IZHA dhe MASR certifikuan **150 mësues** nga 13 drejtori arsimore si mësues TOT. Trajnerët e mësuesve janë trajnuar për 110 orë në total gjatë 1 viti. Janë organizuar 2–4 ditë kurse trajnimi formale të trajnerëve (ToT), ku pas tyre trajnuesit dhanë detyra shtëpie, shpërndanë leksione për modelet e mësimdhënies dhe më pas trajnuan mësuesit e tjerë (zakonisht 10 – 30 në të njëjtën kohë). I tërë procesi u monitorua dhe u vlerësua nga IZHA dhe UNFPA. Në fund të vitit 2016, ishin realizuar 150 kurse trajnimi për mësuesit në të gjithë vendin, në 13 Drejtori Arsimore Rajonale. Në këtë mënyrë, u arritën të trajnoheshin rreth 3,000 mësues.

Gjatë vitit 2018 vijoi trajnimi i mësuesve dhe pilotimi në shkallë vendi i materialeve didaktike “Edukimi seksual si aftësitë për jetën” sipas një skeme ku një mësues TOT trajnon rreth 10 mësues. Gjithsej u certifikuan si mësues TOT- **648 mësues sipas ndarjes së mëposhtme:**

- **288 TOT profili mësues Arsimin Fillor**
- **105 TOT profili mësues Edukim fizik (AMU+GJIMNAZ)**

- **130 TOT profili mësues Biologji (AMU+GJIMNAZ)**
- **125 TOT profili mësues Qytetari (AMU+GJIMNAZ)**

Trajnimi i mësuesve u shtri në 5 DAR-e ku problematikat ishin më të mprehta duke trajnuar në këtë mënyrë rreth **2000** mësues për të gjitha ciklet e shkollimit.

Gjatë vitit 2019 janë zgjeruar kapacitetet trajnuese në 8 drejtori arsimore dhe pritet të trajnohen rreth 40 trajnerë X 10 mësues X 8 njësi arsimore vendore arsimore = 3200 mësues .

Rezulton se nga 2015 – 2016 MASR dhe IZHA certifikuan 150 mësues TOT të cilët trajnuar rreth 3000 mësues të tjerë rreth çështjeve të edukimit shëndetësor dhe seksual.

Gjatë vitit 2018 MASR dhe IZHA certifikuan 648 mësues TOT ndërsa numri i mësuesve të trajnuar në 5 DAR-e arriti në 2000.

Gjatë vitit 2019 janë zgjeruar kapacitetet trajnuese në 4 Drejtori Rajonale dhe 4 Zyra Arsimore ndërsa pritet të trajnohen rreth 3200 mësues në lidhje me çështjet e edukimit seksual.

Jashtë shkolle

Shumë ndërhyrje janë realizuar përgjatë 25 viteve të fundit në Shqipëri për të përmirësuar edukimin seksual tek të rinjtë në mjedise të ndryshme jo-formale. Ndërhyrjet në këto mjedise synojnë, ndër të tjera, të arrijnë sa më shumë të rinj që nuk ndjekin shkollën ose që i përkasin grupeve të marginalizuara. Fillimisht këto ndërhyrje kanë patur në fokus përmirësimin e njohurive, qëndrimeve dhe aftësive ndaj çështjeve të tilla si planifikimi familjar (kontracesioni modern), shtatzënia dhe kujdesi gjatë lindjes; Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme, duke përfshirë HIV dhe AIDS. Në dekadën e fundit janë adresuar më shumë çështje të tilla si dhuna dhe abuzimi seksual, të drejtat e njeriut dhe seksualiteti, si dhe reduktimi i stigmeve ndaj të rinjve që i përkasin grupeve vulnerabël.

Që nga fillimi i viteve 2000 në Shqipëri janë zhvilluar studime të ndryshme për të vlerësuar jo vetëm njohuritë, por edhe sjelljet seksuale të të rinjve shqiptarë. Ndërkohë që ka një përmirësim të ndjeshëm të njohurive mbi Shëndetin Seksual dhe Riprodhues, (ShSR), ende në Shqipëri, sjelljet seksuale të shëndetshme raportohen në nivele të ulëta. Sipas Studimit Demografik dhe Shëndetësor 2017/18, njohuritë e të rinjve për metodat moderne kontrceptive janë mjaft të mira, përafërsisht 96% për grup-moshën 15 – 24 vjec. Nga ana tjetër, niveli i përdorimit të këtyre metodave është mjaft i ulët. Po të përqëndrohemi te përdorimi i prezervativit, vetëm 1.7% e të rinjve të moshës 15-24 vjeç e përdorin atë, duke na paraqitur kështu një prevalence shumë të ulët të përdorimit të tij. Këto rezultate sugjerojnë nevojën urgjente për të punuar më shumë me të rinjtë, brenda dhe jashtë shkolle në fushën e shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.

Tabela 1 paraqet një listë të studimeve kombëtare të kryera në Shqipëri gjatë dy dekadave të fundit, të cilat kanë kontribuar në identifikimin e problematikave shëndetësore të lidhura me ESGJ dhe në adresimin e tyre si prioritete gjatë hartimit të dokumenteve të ndryshëm politikë, të cilat paraqiten në tabelën 2.

Tabela 1

Afati kohor	Studime të kryera në popullatë	Partnerët kryesorë
2002	Studimi mbi Shëndetin Riprodhues (RHS)	MSH, ISHP, USAID CDC
2005	Studim mbi sjelljet në risk tek të rinjtë e shkollave të mesme në Shqipëri	MASh
2005	Studimi i Survejancës Biologjike dhe të Sjelljes në Shqipëri (Raundi I)	USAID, ISHP, FHI
2008	Studimi i Survejancës Biologjike dhe të Sjelljes në Shqipëri (Raundi II)	Fondi Global
2008-2009	Studimi Demografik dhe Shëndetësor 2008/09	USAID, UNICEF, UNFPA, OBSh, ISHP, INSTAT
2009	Studim mbi Sjelljet Shëndetësore të Fëmijëve të moshës shkollore 2008/09	UNFPA, ISHP
2009	Studim mbi sjelljet në risk tek të rinjtë e shkollave të mesme në Shqipëri	ISHP, UNFPA
2011	Studimi European mbi përdorimin e alkoolit dhe drogave të tjera midis të rinjve në Shqipëri (ESPAD)	EMCDDA, ISHP
2012	Studim mbi Prevalencën e Përvojave Negative gjatë Fëmijërisë tek studentët shqiptarë	OBSh, FM
2013	Analizë e situatës mbi parandalimin e keqtrajtimit të fëmijëve në Shqipëri: rruga drejt progresit	Fakulteti i Mjekësisë, OBSh
2014	Studim mbi Sjelljet Shëndetësore të Fëmijëve të moshës shkollore 2013/14	ISHP, FM, UNFPA, UNICEF
2015	Studimi i Survejancës Biologjike dhe të Sjelljes tek Personat e Burgosur	UNFPA, STOP-AIDS, ISHP
2015	Studimi European mbi përdorimin e alkoolit dhe drogave të tjera midis të rinjve në Shqipëri (ESPAD)	ISHP
2015	Abuzimi seksual i fëmijës brenda rrethit të besimit	USAID, TdH
2017-2018	Studimi Demografik dhe Shëndetësor 2017/18	SDC, UNICEF, UNFPA, ISHP, INSTAT
2018	Studim mbi Sjelljet Shëndetësore të Fëmijëve të moshës shkollore 2017/18	ISHP, FM, UNFPA
2019	Studimi i Survejancës Biologjike dhe të Sjelljes në Shqipëri	Fondi Global

Tabela 2

Afati kofor	Veprime politike	Aktorët dhe partnerët kryesorë
2006	Komiteti Kombëtar për Shëndetin Riprodhues	MSH, ISHP, UNFPA, UNICEF, OBSH
2009	Dokumenti Strategjik për Shëndetin Riprodhues 2009-2015	MSH, UNFPA
2012	Memorandum Bashkëpunimi midis MSH dhe MASH	MSH, MASH
2014	Protokolle dhe udhërrëfyes për kujdesin shëndetësor gjatë dhe pas shtatzënisë	MSH, UNICEF, UNFPA
2015	Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020	MMSR, UNFPA
2015	Rishikimi i Paketës Bazë të Shërbimeve në Kujdesin Shëndetësor Parësor	MSH, UNFPA, UNICEF, OBSH
2015	Rishikimi i Standarteve për Shërbimet Miqësore për të Rinjtë	MSH, UNFPA, QSHZHP
2016	Strategjia Kombëtare për Sëmundjet Jo të Transmetueshme 2016-2020	MSHMS, ISHP, OBSH
2016	Hartimi i Udhërrëfyesit Klinik për Shëndetin, Rritjen dhe Zhvillimin e Adolehentit	MSHMS, UNFPA, QSHZHP
2017	Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2017-2021	MSHMS, ISHP, UNFPA, UNICEF, OBSH
2017	Plani i Veprimit për Promocionin e Shëndetit 2017-2021	MSHMS, ISHP, UNFPA, HAP
2019	Rishikimi i Udhërrëfyesit Klinik për Shëndetin, Rritjen dhe Zhvillimin e Adolehentit	MSHMS, UNFPA, QSHZHP

Një rol shumë të rëndësishëm në promovimin e ESGJ në mjedise formale dhe jo-formale kanë luajtur institucionet shëndetësore, arsimore si dhe OJQ të ndryshme. Në vitin 2012 u miratua një Memorandum Bashkëpunimi midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave¹ me qëllim përmirësimin e shërbimit shëndetësor në shkolla, nëpërmjet informimit, edukimit dhe komunikimit për të përmirësuar sjelljet shëndetësore të fëmijëve dhe të rinjve 6-18 vjeç. Memorandumi parashikonte, veç të tjerash, edhe trajnimin e stafit mësimor dhe shëndetësor në shkolla, lidhur me komunikimin e përshtatshëm për çështje të rëndësishme shëndetësore, duke përfshirë edhe edukimin seksual.

Tabela 3 paraqet aktivitetet dhe ndërhyrjet kryesore të zhvilluara gjatë dy dekadave të fundit në Shqipëri, të cilat kanë synuar përmirësimin e nivelit të njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të shëndetshme seksuale të të rinjve shqiptarë. Edhe pse ka shumë ndërhyrje dhe aktivitete që janë kryer gjatë 20 viteve

të fundit, shumica e tyre nuk kanë qenë të qëndrueshme dhe kanë funksionuar vetëm në kuadër projektesh të financuara nga agjensi të ndryshme ndërkombëtare. Në përgjithësi, institucionet shëndetësore qendrore dhe lokale nuk sigurojnë një fond të veçantë të dedikuar vetëm për zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese, përfshirë edhe ato për edukimin seksual.

Kjo situatë vështirëson planifikimin efektiv të punës, duke rrezikuar suksesin e ndërhyrjeve. Instituti i Shëndetit Publik është institucioni kryesor që prodhon çdo vit një sasi të caktuar materialesh informative, duke përfshirë edhe ato për edukimin seksual dhe i shpërndan ato në të gjitha rrethet e Shqipërisë.

Tabela 3

Afati kohor	Aktivitetet dhe ndërhyrjet kryesore	Aktorët dhe partnerët kryesorë
2002	Sistemi Kombëtar për Menaxhimin dhe Informacionin Logjistik të Kontraceptivëve (LMIS)	MSH, ISHP, USAID
2003	Pilotimi i shërbimeve miqësore për të rinjtë	UNICEF, UNFPA
2006-2007	Trajnimi Kombëtar i Trajnerëve për ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe psikologët e shkollave mbi shërbimet miqësore për të rinjtë dhe ato të SHR	UNFPA, ISHP
2007-2011	Programi i Fondit Global	Fondi Global, MSH, ISHP
2007 – 2011	Revista e Shëndetit Riprodhues (e përmuajshme)	ISHP, UNFPA
2009-2011	Programi Shqiptar i Planifikimit Familjar C-Change	USAID
2010-në vazhdim	Fushata vjetore kombëtare për ShSR (“Dita Botërore e Kontraceptivëve - 26 Shtator)	ISHP, MSH, UNFPA, ACPD
2011-2014	Trajnimi kombëtar i punonjësve të shëndetësisë për dhunën me bazë gjinore	MSH, UNFPA, QKSS
2012	Paketa e trajnimit kombëtar për punonjësit shëndetësorë në shkolla (13 module), bazuar në tetë kompetencat (një modul mbi: Shëndetin Seksual dhe Riprodhues)	MSH, ISHP, OBSH
2014	Paketa e trajnimit kombëtar për ESGJ	UNFPA, ACPD
2018 - 2019	Programi i Fondit Global	Fondi Global, MSHMS, OKB, OJQ

Në vitin 2003 në dy rrethe të Shqipërisë, Tiranë dhe Vlorë, UNICEF mbështeti dizenjimin e një modeli të ri të shërbimeve shëndetësore miqësore për të rinjtë, i integruar në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor. Modeli synonte të përditësonte shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor me protokollet dhe shërbimet e reja që janë sensitive për moshën dhe gjininë dhe që janë të përshtatshme për nevojat e adoleshentëve dhe të rinjve. Modulet e hartuara për trajnim u testuan nga stafi i këtyre qendrave. Modeli u përfshi në strategjinë e parë kombëtare për rininë në vitin 2015. Ky model u mbështet nga UNICEF për periudhën 2003 – 2006 dhe u supervizua edhe për dy vjet të tjera. Shërbimet miqësore për të rinjtë kanë vazhduar të ofrohen kryesisht përmes OJQ-ve si ACPD në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë.

Gjatë dy dekadave të fundit, OJQ të ndryshme kanë punuar për të promovuar dhe zbatuar programet e edukimit seksual në Shqipëri. Ato kanë bashkëpunuar ngushtë me institucione shtetërore në nivel lokal, si psh me specialistë të promociionit shëndetësor nga Drejtoritë e Shëndetit Publik për të rritur ndërgjegjësimin dhe promovuar përdorimin e shërbimeve nga komuniteti.

Vlen të thejsohet edhe roli i disa OJQ, si STOP AIDS dhe Aksion + në arritjen me informacion dhe shërbime përsa i përket grupeve më të riskuara të të rinjve nga HIV dhe AIDS si dhe grupeve me vulnerabël të të rinjve.

Edukimi seksual midis grupeve vulnerabël ka qenë një sfidë e rëndësishme në Shqipëri. Për shkak të marginalizimit të tyre, shpesh herë ka qenë me e vështirë arritja e këtyre grupeve. Dy programet e Fondit Global (2007-2011 and 2018-2019) kanë adresuar në mënyrë të veçantë nevojat e këtyre grupeve dhe kanë synuar fuqizimin e tyre në aspektin e njohurive dhe sjelljeve të shëndetshme, të cilat reduktojnë mundësitë për t'u infektuar me HIV. Edukimi seksual ka qenë pjesë e këtyre ndërhyrjeve. Mbetet sfidë vazhdimi i këtyre ndërhyrjeve edhe pas përfundimit të raundit të dytë të Programit të Fondit Global në Shqipëri.

Promovimi i ESGJ ka hasur në shumë sfida në Shqipëri. Ende ka rezistencë nga prindërit dhe kujdestarët, anëtarët e komunitetit, sikurse dhe nga mësuesit, të cilët e shohin edukimin seksual si një faktor që i çon të rinjtë drejt marrëdhënieve seksuale të hershme. Ata argumentojnë se kjo gjë është kundër kulturës shqiptare, se shkollat duhet të promovojnë vlera në vend të edukimit seksual, se edukimi seksual mund të jetë i nevojshëm për të rinjtë, por jo për fëmijët në moshë të vogël.

Sigurisht, adresimi si duhet i kësaj rezistence dhe sfide kërkon qasje dhe marrjen e disa hapave dhe ndërhyrjeve të mirëmenduara.

Progresi drejt të ardhmes

- Përshkallëzimi i programeve kombëtare ekzistuese mbi ESGJ, duke u fokusuar si në përmirësimin e programeve të bazuara në shkollë, ashtu edhe në qasjet komunitare, ku përfshirja e të rinjve është thelbësore.
- Financimi i duhur i ESGJ, duke përfshirë edhe trajnimin e mësuesve.
- Financimi i duhur i aktiviteteve për Informim, Edukim dhe Komunikim (IEK) për promovimin e shëndetit, të cilat mbështesin dhe synojnë komunikimin për ndryshimin e sjelljes për një ndryshim pozitiv shoqëror.
- Përshkallëzimi në nivel kombëtar i shërbimeve shëndetësore miqësore për të rinjtë, të cilat do të eliminojnë barrierat në komunikim mbi çështje të lidhura me shëndetin seksual dhe riprodhues midis të rinjve.
- Reflektimi në nivel lokal i integritit të shëndetësisë dhe punës sociale, nëpërmjet një përfshirjeje më të mirë të institucioneve respektive locale, duke përfshirë komunitetet dhe bashkitë.
- Zgjerimi i mbështetjes për organizata dhe institucione që sigurojnë dhe ofrojnë kujdes për shëndetin seksual dhe riprodhues në Shqipëri.
- Shoqërimi i ndërhyrjeve të ESGJ me sensibilizim të komuniteteve, veçanërisht të prindërve, që synojnë ndryshimin e normave sociale rreth seksualitetit dhe ESGJ dhe sigurojnë hapësirë për të rinjtë që të ndikojnë dhe të kërkojnë të drejtat e tyre.

REFERENCA

- Memorandumi I Bashkëpunimit midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Prot. Nr. 1855, Dt. 07/05/2012
- Dokumenti Strategjik për Shëndetin Riprodhues 2009-2015 https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/0_DOKUMENTI_STRATEGJIK_mars_2009.pdf
- Analizë e situatës mbi parandalimin e keqtrajtimit të fëmijëve në Shqipëri: rruga përpara http://www.euro.who.int/_data/assets/pdf_file/0016/306331/Situation-analysis-prevention-child-maltreatment-Albania-en.pdf?ua=1
- Plani i Veprimit për Promocionin e Shëndetit 2017-2021 http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2017/05/PLANI-VEPRIMIT-PROM-SHEND_2017-2021.pdf
- Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2017-2021 shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/SRH_National_Strategic_Document_2017_-_2021.pdf
- Strategjia Kombëtare për Sëmundjet Jo të Transmetueshme 2016-2020
- Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020 <https://www.un.org.al/publications/national-youth-action-plan-2015-2020>
- Studimi Shqiptar Demografik dhe Shëndetësor 2008/09 http://ishp.gov.al/wp-content/uploads/ADHS_2008_09_Final_Report_English.pdf
- Studimi Shqiptar Demografik dhe Shëndetësor 2017/18 <https://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/04/ADHS-2017-18-Complete-PDF-FINAL-ilovepdf-compressed-1.pdf>
- Studim mbi Prevalencën e Përvojave Negative gjatë Fëmijërisë tek studentët shqiptarë, 2012. http://www.euro.who.int/_data/assets/pdf_file/0016/181042/e96750.pdf
- Studim mbi Sjelljet Shëndetësore të Fëmijëve të moshës shkollore 2013/14. <http://www.euro.who.int/en/publications/abstracts/growing-up-unequal-gender-and-socioeconomic-differences-in-young-peoples-health-and-well-being.-health-behaviour-in-school-aged-children-hbsc-study-international-report-from-the-20132014-survey>
- Abuzimi seksual i fëmijëve brenda rrethit të besimit, 2015. [http://childhub.org/child-protection-online-library/sexual-abuse-circle-trust-research-albania-report?language=en&listlang\[\]=***CURRENT_LANGUAGE***](http://childhub.org/child-protection-online-library/sexual-abuse-circle-trust-research-albania-report?language=en&listlang[]=***CURRENT_LANGUAGE***)
- Analizë e situatës mbi parandalimin e keqtrajtimit të fëmijëve në Shqipëri: rruga drejt progresit, 2015. http://www.euro.who.int/_data/assets/pdf_file/0017/307520/Situation-analysis-prevention-child-maltreatment-Albania-a1.pdf?ua=1



Ensuring rights and choices for all since 1969



ICPD25

International Conference on
Population and Development



<https://www.facebook.com/UNFPAAlbania>



<https://www.twitter.com/UNFPAAlbania>



<https://www.instagram.com/unfpaalbania>



website: albania.unfpa.org